



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 12/12/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Eskavator me goma”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV Automjete të rënda me Kod 34140000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,000,000 (gjashtë milion) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2023, për objektin: “**Blerje eskavator me goma**”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$6,000,000 \times 30\% = 1,800,000$ (një milion e tetëqind mijë) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore per vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$6,000,000 \times 20\% = 1,200,000 \text{ (një milion e dyqind mijë) Lekë.}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpermjet të cilës marrin përsipër që "Garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)".

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkt (mjet) funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë se nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Patos.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

2.3.4. Për mjetin duhet të paraqiten fotografi të qarta nga të gjitha anët dhe origjinale.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 6/b të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë vendndodhjen e mjetit (adresën e saktë) si dhe të dhënat përkatëse të mjetit me qëllim që Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos të bëjë verifikimin fizik të gjendjes teknike dhe vizuale të mjetit përpara shpalljes së ofertës fituese për operatorët ekonomik të kualifikuar sipas renditjes. Përben kusht për skualifikim nëse nga verifikimi vërehet se kemi mospërputhje të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkt (mjet) funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6. Njëkohësisht operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për mjetin që do të ofertojnë duhet të paraqesin dhe të ngarkojnë në sistemin e prokurimit skeden

teknike me të dhënat përkatëse të Automjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të mjetit si, Foto, Siguracion, Certifikatë pronësie, Certifikatën e Kontrollit teknik të mjetit dhe librin e historikut të shërbimeve të përkthyer në gjuhën shqipe nëse libri original është në gjuhë të huaj te vitit te fundit aktual.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6/c dhe pika 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale (mjetin) dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Specifikimet për mjetin

Viti i prodhimit: Nuk do të pranohet asnjë mjet i cili është prodhuar para vitit 2010.

Dokumentacioni i kërkuar: Mjeti të jetë i pajisur me:

- Certifikatë Pronësie (nuk kërkohet certifikatë pronësie në rastin që mjeti ka leje qarkullimi të re)
- Targa Shqiptare,
- Siguracion të vlefshëm
- Të ketë kryer kontrollin teknik me cilësinë “kalon”.

Cilësitë e kërkuara të mjetit

Ngjyra: Nuk ka përcaktim

Sistemi i ndriçimit: Të jetë i kompletuar me sistemin ndriçimit origjinal si dhe me dritat mjegulluese.

Dyert: ≥ 1 (një)

Çelsat: Mjeti duhet të jetë i pajisur me 2 (dy) Çelsa orgjinale.

Numri i ndenjësve: ≥ 1 (një) ndenjësë

Sistemi ajrosjes së kabinës: Mjeti duhet të jetë i pajisur me sistem kondicioner funksional.

Lloji i karburantit: Diesel (Naftë)

Motori: Mjeti duhet të jetë i pajisur me një motor me 4 (katër cilindra) i pajisur me turbo.

Madhësia e motorit: Diapazoni i madhësisë së motorit duhet të jetë 4400 - 4600cc.

BHP Kuaj Fuqi: Mjeti duhet të ketë kuaj fuqi midis intervalit 115 – 125 kuaj fuqi (kjo është e barabartë me 85.7kw – 93.2kw).

Pesha e mjetit: 15,500 – 16,000 kg

Gomat: Mjeti duhet të jetë i pajisur me një set gomash $\geq 85\%$ të reja (1 set ka 4 goma).

Origjina e mjetit përsa i përket përdorimit në rrugë: Mjeti duhet të jetë prodhuar specifikisht për përdorim në Europë. Ky kriter kërkohet sepse performaca e mjetit është konform rregullores së Federatës Ndërkombëtare të Automobilave (Federation Internationale de l'Automobile, FIA) për mjetet që qarkullojnë në Kontinentin Europian.

Historia e aksidenteve: Mjeti duhet të jetë “accident free” pra nuk duhet të ketë një histori aksidenti, për këtë kriter mjeti do të ushtrohet një kontrolli të vecantë nga një komision i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Shasia: Mjeti nuk duhet të ketë ndryshk, zëvendësime apo prerje të trupit të cilat mund të jetë salduar apo modifikuar për të sjellë në gjendjen e mëparëshme.

Pamja vizuale: Mjeti nuk duhet të ketë gërvishtje, shtypje ose deformime, xhamat nuk duhet të jenë të krisur ose të thyer.

Pjesët gjenerike dhe mekanike: Të gjitha pjesët gjenerike dhe mekanike duhet të jenë minimalisht të reja në masën 90%.

Pajisjet digitale: Pajisjet digitale si paketa, dhe sistemet elektronike duhet të jenë 100% funksionale, nuk do të pranohet asnjë mjet i cili pa paketa të ndërruara jo origjinale ose të përdorura dhe të koduara nga persona apo oficina jo të licensuara nga kompania prodhuese e mjetit.

Kovat metalike: Mjeti duhet të jetë i pajisur me një set kovash. Një set kovash përmban 3 kova të cilat janë në madhësi të ndryshme.

Sistemi elektrik

- Tensioni i funksionimit 24V
- Bateritë pa mirëmbajtje 2
- Kapaciteti total 100 Ah
- Alternator trefazor 70 A

Sistemi hidraulik

Sistemi hidraulik S.H.S. (Smart Hydraulic System) për kontroll të përsosur dhe njëkohësi të të gjitha lëvizjeve të punës. Qarku i mbyllur i sensorit të ngarkesës.

Sistemi automatik i përparësisë A.P.S. (Sistemi Automatik i Prioritetit). Monitorimi i shpejtësisë së motorit E.S.S.C. (Kontrolli i sensorit të shpejtësisë së motorit) për shfrytëzim të përsosur të fuqisë hidraulike.

S.P.C. (kontrolli i presionit të lëkundjes). S.P.C. Kontrolli ndikon automatikisht në shpejtësinë e shpërndarjes së pompës rrotulluese.

F.P.S. (Kursimi i pompës së rrjedhës) kontrolli i rrjedhës dhe S.L.S. (Sistemi i goditjes më pak) Sistemi i lehtësimit të presionit për kontroll të përsosur të imët dhe lëvizje të qëndrueshme të punës.

E.T.U. Ekran shumëfunksional (Easy To Use) me funksione të para-programuara:

- Koha
- Programi i mirëmbajtjes
- Vetë-diagnoza
- Shpejtësia e drejtimit
- Shpejtësia e motorit

Sistemi i çekiçit/gripës me dy drejtime

Kontroll i pavarur i çekiçit / kapëses dhe cilindrit rregullues
(pajisja e rregullimit hidraulik)

Pompa kryesore - shkalla maksimale e dërgesës:

- për pajisje pune dhe makinë udhëtimi 182 l/min
- Lëkundje 90 l/min

Presioni maksimal i punës:

- Pajisje/shasi 350 bar
- Mekanizëm rrotullues 200 bar

- Cilindri hidraulik	me ngarkesë të dyfishtë
- Cilindri ngritës	2
- Hapje x goditje	105 x 980 mm
- Cilindri i krahut	1
- Hapje x goditje	110 x 1140 mm
- Cilindri i kovës	1
- Hapje x goditje	90 x 995 mm
- Cilindri aktivizues	(pajisja rregulluese) 1
- Hapje x goditje	145 x 730 mm

Zbutës hidraulik i pozicionit fundor.

Ngarkesa e reduktuar në komponentë dhe lehtësia e përmirësuar e përdorimit.

Ngjitja

Ndërrimi automatik ose manual i motorit hidraulik. Transmetim i sinkronizuar për punë dhe udhëtime në rrugë. Kalimi nga mënyra e punës në shpejtësinë e drejtimit nëpërmjet kompjuterit në bord për siguri maksimale në punë dhe lehtësi në përdorim. Faza e ndërrimit të marsheve zgjidhet duke përdorur një ndërprerës presioni. T.D.C. -Pajisja (kontrolli i motorit të udhëtimit) zvogëlon përpjekjen e frenimit të frenave të shërbimit kur drejtohet mjeti në zbritur.

Boshtet rrotullues

Boshtet me frena të integruara me shumë disqe në një vaskë vaji që veprojnë drejtpërdrejt në shpërndarës.

Bosht i pasmë i ngurtë.

Bllokimi i boshtit të lavjerrësit $\pm 7^\circ$

Boshti i përparmë mund të bllokohet në çdo pozicion. Valvul sigurie për mbylljen automatike të boshtit.

Sistemi i frenimit

Frena e shërbimit: frena me shumë disqe në një depozitë vaji që vepron në të 4 rrotat. Frena e punës: frena shërbimi me mbyllje shtesë të boshtit të lavjerrësit. Frena e parkimit: frena me shumë disqe me ngarkesë në një depozitë vaji. Frena e sigurisë: frena me 2 qark dhe frenë parkimi me fikje automatike të motorit.

Sistemi i drejtimit

- | | |
|-----------|----------------------------|
| - Lloji: | ORBITROL me valvul sigurie |
| - Pompë : | Pompë ingranazhesh |

- Cilindri i drejtimit: 1, dyfish i ngarkuar
- Këndi i drejtimit: 27°
- Rrethi minimal i rrotullimit me goma binjake: 12100 mm

Specifikimet teknike të Hartuara janë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor bazuar në pikën 2 neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar për të patur një Automjet cilësor e të përshtatshëm për funksionalitetin e veprimtarive që zhvillohen.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **26/12/2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Eskavator me goma”

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT